Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit 29.04.2022*	*Data e dorëzimit të raportit 10.05.2022*	Nr. i lëndës: *115/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.04.2022, OE **"Merkatori"Sh.a** – Gjilan,ka parashtruar ankesë me nr: 115/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE **NT "Egnatia" -** Kmetofc, lidhur me aktivitetin e prokurimit, " Transporti i nxënësve,ndarja në Lote 6,10,13,19"-Ritender,me nr.të prokurimit: 651-21-9927-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"KK Gjilan".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:Kontratë Publike Kornizë,**Shërbime**,vlera e parashikuar e kontratës: **156,077.75 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni. 7.1. Barazia në trajtim /jo diskriminim: AK, Nuk i trajton OE të barabart në garë duke favorizuar Operatorin me qmim më të lartë, për 3.610,00€, e duke mos Pasur Dokumentin e përshkrimit të QMIMIT për Lot-19 dhe Identifikim të OE siqë shifet në qmimin e ofruar nga OE"Merkatori", Po ashtu në Vërtetimin e ATK-s është DELIKUENT në pagesen e TATIMEVE ndaj Shtetit.

Neni. 17. Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës për shërbime,

Neni 27.1. Dosja e Tenderit:

Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet 3materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues.

Neni. 59. Ekzaminimi, Vlersimi dhe krahasimi i Tenderëve:

1. *Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.*

Neni. 60. Kriterin për dhënje Kontratës, duke e favorizuar OE me qmim më të lartë, me 3.610,00 €
***QMIMI i Ofruar nga "Merkatori" është : Totali i përgjithshëm i QMIMIT =24.790,00€ dhe me vetëm dy shifra pas presjes dhjetore, shif përshkrimin e qmimit për Lot-19. (Ska lidhje me Vlersimin e AK)**

Neni.18.paragrafi 4. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik :

18.4 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron **të gjitha informatat relevante** për kontratës në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të **përfshijnë** të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. **Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.** Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.

Neni.20. Dosja e Tenderit Gjat pregaditjes nuk ka qen ne harmoni me Rregullat dhe Udhzuesi Operativ për Prokurim Publik. Neni 18.paragrafi 3. (Shif dosjen e tenderit neni.20.pparagrafi.1)

20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro **(€) dhe** duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. **Çmimi i ofertuar** lejohet qe te shenohet me maksimum dy (2) numra pas preses dhjetore. Çdo numer i shenuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret per baze ne llogaritje te vleres se ofertes.

*1.Tenderi për her të parë u publikue me dt.**06.09.2021**. me nr.pr.Brendshëm:**GL-651-021-066-211** me titull: Transporti i nxënësve në Lote, icili pjesrisht është analuar për disa Lote, e edhe Lot-19.*
***2.OE 'EGNATIA" Kmetofc**, edhe në atë kohë pasi muarr pjes në tender dhe kishte ofruar qmimin më të ulët prej vetëm **0,58 euro** **për 1.km.** (ishte më i favorshmi nga katër OE Konkurues) Vlera e parashikuar e Qmimit të kontratës ishte VETËM = **8.000,00Euro**.*
***Për Lot-19.** Shtrohet pytja Logjike pse AK, nuk e shpërbleu me kontratë?????PSE????*

3.AK** e anulon Nje pjes te tenderit pa kurfar sqrimi, dhe Vendimi publikë, pra edhe **Lot-19** ,pasi pronari i kompanis "Egnatia"bëri **MARVESHJE TË MSHEFTË** me OE konkurues, për Lot-19.duke u tërhequr nga disa Lote që po ata **OE** ishin të interesuar ti përfitonin. Në lidhje me këtë në zyrët apo edhe e-majliet zyrtare të AK gjinden Faktet për tërheqje nga ana e OE për **Lot-19.

4.R-i Tenderimi** ka ndodhur me **06.12.2021**. por me një Qmim të Vlerës së Kontratës të Trefishuar në **28.400,00€ për Lot-19.** Kusht për dhënjen e kontratës: **Qmimi më i ULËT:
*Me **24.12.2021**. Bëhet Hapja e tenderve ku kishte vetëm dy (2) ofertues: **"Merkatori"sh.a.** dhe **N.t."Egnatia"** .*
*Me dt.**31.01.2022**. Ne pranojm: Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit.*
*Me dt.**01.02.2022**.Unë si përfaqsuesi kompanis"Merkatori"Sh.a. i ofroj sqarime se si kam ardhe deri te aji qmim(tani ja bashkangjes)*
Me datat: 09.02;10.02.e18.02. kami pranuar Letër Standarde për Tenderuesin e Sukseshëm,
Me dt.**12.04.2022.** Kam pranuar një Letër Standarde pas një Rivlersimi të kërkesës për Ri-Shqyrtim nga OE"Egnatia"se me këtë tender shpërblehet kompanis "Egnatia" ndërsa "Merkatori" sh.a. Gjilan, Eliminohet nga Gara e mëtutjeshme.
Me dt.15.04.2022. Ushtroj Kërkes për Ri-Shqyrtim te AK
Me.dt.21.04.2022. Pranojmë VENDIMIN e Rrefuzimit të kërkesës për Rishqyrtim,
Me dt.22.04.2022. Me lejohet qasja ne dokumentet e OE "Egnatia" me qka konstatove se:
***Në dosjen e tenderit të OE"Egnatia" egziston nji dokument të cilin AK e konsideron si përshkrim të qmimit, pa Logo të Autoritetit Kontraktues, pra Komnua e Gjilanit, pa përcaktim se për cilin LOT tenderon, pa Identifikim te Operatorit Ekonomik dhe Personit te Autorizuar të njejtit (gjeni të bashkangjitur ankesës),**

*Në kundërshtim me LPP dhe dosjen e tenderit i njejti shpërblehet me kontratë, duke qen **DELIKUENT** i pagesës tatimeve daj shtetit **(shif Vërtetimin)** që do bashkangjes, i njejti posedon një marveshje për shlyerjen e borqeve të **Prapambetura, (po të mos ishte DELIKUENT s`do të kishte borqe për të bër marveshje).**

***Kërkesat për OE të Përgjegjësëm:** c. Për situatën referuar pikës 6.3 ëh (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vititë *para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]*

** OE"Engatia" do të duhej të shpallet i **PAPËRGJGJËSHËM** për kto dy dokumente **Përshkrimin e Qmimit** dhe **Vërtetimin e ATK-së**, e jo të shpërblehet me kontratë duke qenë me qmim më të lartëpër: **3.610,00€,***

****ktu i vjen era e tëra POLITIKË.***

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e tenderit

20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit

20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro **(€) dhe** duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. **Çmimi i ofertuar** lejohet qe te shenohet me maksimum dy (2) numra pas preses dhjetore. Çdo numer i shenuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret per baze ne llogaritje te vleres se ofertes.

20.2 Cmimet e tenderit për shërbimet e ofruara janë të fiksuara gjatë kryerjes së kontratës dhe nuk mund të ndryshohen.

20.3 Në qoftë se tenderët janë ftuar për kontratat individuale (lot-e) çmimet e ofruara duhet të korrespondojë me 100% të artikujve të specifikuar për secilën pjesë (lot) dhe 100% për sasitë e specifikuara për secilin pozicion për atë pjesë(lot).

-Tabela e çmimeve

kërkesat e përshtatshmërisë

pika b është kërkuar,ërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] – Vërtetimin nga ATK-ja-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit,komisioni rivlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni për rivlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në raportin e tyre të datës 06.04.2022, nga dy (2) oferta të pranuara për Lot 19, vetëm një ofertë e ka vlerësuar si të përgjegjshme duke rekomanduar për kontratë si ofertë fituese ofertën OE NT "Egnatia" – Kmetofc si ofertë me çmim më të ulët prej 0.98 € për km, €.

Sa i përket ofertës së OE ankues "Merkatori"Sh.a,nga komisioni i vlerësimit kjo ofertë është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin;
OE "Merkatori"Sh.a"për listën e çmimeve që ka ofertuar është i papërgjegjshëm sepse sipas Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik neni 18.Dosja e tenderit,pika18.3"Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro(€).Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore.Nëse OE ofron çmim më me shumë se dy(2) numra pas pikës dhjetore,oferta e tillë do të

konsiderohet e papergjegjshme.Në rast se AK lejon çmime me më shumë se (2) numra pas oukës dhjetore,atëherë AK duhet të cekë këtë decidivisht në Dosjen e Tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde"

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "MERKATORI"SH.A

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Merkatori"Sh.a,se AK gjatë rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se ka ofruar çmim me më shumë numra pas pikës dhjetore (0.8260 për km) që sipas OE ankues AK nuk ka bërë vlerësimin e tendereve konform nenit 59 të LPP-së dhe çmimi total vetëm është dashur të korrigjohet (+/- 2%), eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "Merkatori"Sh.a gjatë dorëzimit të tenderit për Lot 19 ka dorëzuar këtë tabelë të çmimeve të prezentuar më poshtë:

KUVENDI KOMUNAL
GJILAN

PJESA -II-PËRSHKRIMI I QMIMEVE

LOT-19	TRANSPORTI I NXËNËSVE DHE PUNËTORËVE				
Nr	Përshkrimi i shërbimeve / Relacionit	Njësia Matëse	Çmimi për 1 km.	cmimi pa tvsh	Çmimi me tvsh-18%
1	Transporti i Nxënësve dhe puntoreve	1 KM	0,70	0,70	0,8260
			TOTALI I PËRGJITHSHËM :		24,790.00

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)

Emri i OE	"MERKATORI" SH.A.
Adresa e plotë:	60000 GJILAN, Rr. Idriz Seferi nr.15
Përfaqsuar nga:	
Emri:	Jakup V. BERISHA,
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	24.12.2021
Vula:	

MERKATORI

Bazuar në nenin 18.3 të RRUOPP-së sipas të cilit citoj "Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet qe të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me me shume se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme. Ne rast se AK lejon çmime me më shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK duhet të ceke këtë decitivisht ne Dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde",konsideroj që çmimi i ofruar nga OE ankues është në kundërshtim me nenin 18.3 të RRUOPP-së dhe në Dosje të tenderit tek pika 20.1 nuk është specifikuar që OE mund të ofrojnë çmime me më shume numra pas pikës dhjetore,andaj pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.
Pretendimi ankimor i OE ankues,i cili është thirrur në nenin 59 të LPP-së lidhur me korrigjimin e shumës totale +/- 2% për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk ka të bëjë me këtë rast sepse OE ankues ka ofruar çmim për km prej 0.8260 € që është çmim për njësi dhe çmimet për njësi nuk korrigjohen.

OE me rastin e plotësimit/dorëzimit të formularit të tenderit sipas pikës 1 të formularit të tenderit konfirmojnë se " i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim",andaj pretendimi i OE ankues për paqartësi rreth çmimit me më shumë numra pas pikës dhjetore është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se AK ka shpërblyer me kontratë ofertën e OE NT "Egnatia", edhe pse tabela e çmimit e ofruar nga ky OE është pa logo të Autoritetit Kontraktues, pa përcaktim se për cilin Lot është dhe pa identifikim të personit të autorizuar të OE dhe sipas OE ankues kjo ofertë duhet të shpallej e papërgjegjshme,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar këtë tabelë të çmimeve për Lot 19 ;

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve / Relacionit	Njësia Matëse	Çmimi për 1 km	Çmimi pa tvsh	Çmimi me tvsh
1	Transporti i nxënësve dhe puëtorëve	1 KM	0.98	0.83	0.98
	TOTALI I PËRGJITHSHËM :				0.98

Tabela e çmimit për Lot 19 e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është komplet identike me tabelën e çmimeve për Lot 19 të specifikuar në dosje të tenderit,andaj pretendimi i OE ankues se nuk dihet se për cilin Lot është ofertuar është i pa bazuar sepse tabelat e çmimeve të çdo Loti kanë përshkrime të ndryshme dhe dallojnë nga njëra tjetra,andaj tabela e çmimeve e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë përmban të gjitha përshkrimet dhe kolonat identike me tabelën e specifikuar nga AK në dosje të tenderit.
Sa i përket pretendimit se tabela e çmimeve është pa logo të AK-së, eksperti shqyrtues sqaron nuk është kërkuar që tabela të ketë logon e AK-së sepse as tabela e specifikuar në dosje të tenderit nuk e ka logon e AK-së.Tabela e e çmimeve e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është e vulosur dhe nënshkruar dhe është e dërguar përmes platformës elektronike e-prokurimi dhe pretendimi i OE ankues se nuk ka identifikim të personit të pautorizuar për ekspertin shqyrtues është krejt jo relevante sepse tabela e çmimeve është e vulosur dhe nënshkruar.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Merkatori"Sh.a se OE i rekomanduar për kontratë është delikuent i pagesës së tatimeve sepse ka ofruar vërtetimin tatimor të ATK-së që është në marrëveshje për shlyerjen e borgjeve dhe sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë duhet të shpallej i papërgjegjshëm, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit tek kërkesat e përshtatshmërisë tek pika b është kërkuar,ërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] – Vërtetimin nga ATK-ja-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës.

OE i rekomanduar për kontratë pas kërkesës së AK ka dorëzuar këtë vërtetim të ATK-së;

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

VËRTETIM TATIMOR
TAX VERIFICATION
PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:
Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:
Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:

1000765625

Emri i personit: Name of Person: Ime lice:	Mirushe Latifi B.I.
Numri Identifikues Personal: Personal Identification Number: Identifikacioni Lični Broj:	
Numri Fiskal: Fiscal Number: Fiskalni Broj:	810212415
Komuna: Municipality: Opština:	GJILAN
Data: Date: Datum:	11.02.2022
Arsyeja e lëshimit: Reasoning: Razlog izdavanja:	Aplikim për subvencion

ka këtë gjendje tatimore në ATK:
has the following tax position with the TAK:
ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura
This person is registered with TAK and is currently in an installment agreement to satisfy outstanding tax debts
Lice je registrovana u PAK i aktuelno je u sporazumu u ratama za isplatu ostalih poreskih dugova

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk përfshiron obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova podvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit
The verification is valid for 90 days from the day it is issued
Potvrda vazi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -
Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku:
https://eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer

Nr Formës VT - 2; Korigjuar më 30.04.2013

Bazuar në vërtetimin e ATK-së të datës 10.02.2022 rezulton që OE i rekomanduar për kontratë"Mirushe Latifi" B.I (NT Egnatia) rezulton në marrëveshje me këste për shlyerjen e borgjeve të mbetura.

Eksperti shqyrtues me datë 06.05.2022 përmes e-mailit nga OE i rekomanduar për kontratë NT"Egnatia" ka

kërkuar që ta ofroj marrëveshjen me ATK-në për shlyerjen e borgjeve me qëllim që të verifikohet data e kësaj marrëveshje.
Me datë 06.05.2022 OE i rekomanduar për kontratë ka dërguar përmes e-mailit këtë marrvëshje me ATK-në;

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transferevë - Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës – Poresku Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

DMTB 5101 1 18/01/2021

MARRËVESHJE PËR PAGESË TË BORXHEVE TATIMORE ME KËSTE
Marrëveshja Nr. 12275 Data: 15.01.2021

Administrata Tatimore e Kosovës, e përfaqësuar nga menaxheri i Zyrës Tatimore: **Adrijana Latifi**
Dhe **Mirushe Latifi B.I.** (Tatimpaguesi) me NF: | 8 | 1 | 0 | 2 | 1 | 2 | 4 | 1 | 5 |
Adresa: **KMETOFCË**

Hyn në Marrëveshje Pagese për të paguar borxhet tatimore me këste sipas Rastit të Mbledhjes Nr. **20593 / 15.01.2021**

Sipas kësaj Marrëveshje, tatimpaguesi do të paguajë borxhet e tija në shumën prej **9,813.79** Euro, ku detajet e strukturës janë bashkëngjitur sipas kushteve dhe afateve:

TATIMPAGUESI do të

1. Kryej pagesën paraprake në shumën prej **4,000.00** Euro, e cila është **40.76** % e shumës totale të borxheve dhe do të paguhet më **15.02.2021**
2. Kryej në **24** këste në shumë prej **300.00** Euro për çdo **Mujor**. (*Orari i pagesës është bashkëngjitur*)
3. Paguaj me kohë të gjitha obligimet tjera tatimore pasuese

Bazuar në një interpretim të KRPP-së tek pyetjet e shpeshta (pyetja 64) sqarohet se kur marrëveshja e OE me ATK-në për shlyerjen e borgjeve është para datës së publikimit të njoftimit të kontratës atëherë OE duhet të trajtohet si i pranueshëm, citoj interpretimin e KRPP-së"Në përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se ne cilën periudhe duhet te jete OE i "pranueshëm", ndërlidhet ***me periudhën që menjëherë paraprinë <u>datën e publikimit të njoftimit të kontratës, qe do te thotë se OE duhet te jete i "pranueshëm" ne datën e publikimit te njoftimit.</u>***

Borxhet mund te lindin ne periudha te ndryshme p.sh. gjate procesit te vlerësimit, gjate fazës se ankimimit, prandaj ky nen percakton kohen kur OE duhet te jete i pranueshëm.

Nisur nga fakti se shume OE kane marrëveshje për shlyerje te borxheve me ATK-ne, KRPP sqaron se edhe ne ketë rast marrëveshjet për shlyerje te borxheve duhet te jete para <u>datës se publikimit të njoftimit të kontratës.</u>

Qëllimi i ketij neni është qe OE duhet te jete gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet te ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimi të Njoftimit për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron se data e marrëveshjes së OE të rekomanduar për kontratë me ATK-në është e datës 18.01.2021 dhe është para datës së publikimit të njoftimit të kontratës (06.12.2021), andaj vërtetimi tatimor i ATK-së i OE të rekomanduar për kontratë është në pajtim me interpretimin e KRPP-së.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Konsideroj që AK ka bërë vlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit, andaj rekomandoj që të vazhdohet me lidhjen e kontratës.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të refuzohet si e pa bazuar**,dhe rekomandon autoritetin kontraktues që të **vazhdoj** me lidhjen e kontratës**..**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - "KK GJILAN"
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - "MERKATORI" SH.A